



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKISË GRAMSH

Nr. 1584/prot  
2

Gramsh, më 27/07/2022

VENDIM

Nr. 62 datë, 23/04 / 2022

P Ë R

NDRYSHIM DESTINACIONIT TË PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH  
DHE KTHIMIN E TYRE NË FOND BANESE PËR QËLLIME STREHIMI DHE  
PRIVATIZIMI

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës ,29 / 04 / 2022 , pasi mori në shqyrtim Relacionin dhe P/Vendimin nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori Juridik dhe Menaxhimit të Aseteve Vendore ,në zbatim të ligjit nr,8743,datë ,22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit “të ndryshuar ,neni 3 të ligjit nr,8744, date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësit e qeverisjes vendore “ të ndryshuar, referuar VKM-së nr, 431 datë , 11.07.2007 “ Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore, që transferohen , në pronesi ose në përdorim ,të Bashkisë , Gramsh , të qarkut Elbasan i ndryshuar, të vendimit nr, 500, datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në njësit e qeverisjes vendore “të ndryshuar ,udhëzimit nr.15,datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësia e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike .Në zbatim të ligjit Nr,22,date ,03.05.2018 ,” Për strehimin Social “, Neni 77 ,pika (1) shkronja ,(c) Pika 3 . Në zbatim të VKM-së nr, 614, datë 07.07.2015 , i ndryshuar “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fondë banese . Me vendimë të organeve të njësive të qeverisjes vendore në pronesi të njësive të qeverisjes vendore dhe të shtetit ,ku janë sistemuar me strehim banorët të pajisur me autorizim nga organet kopetente “ Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me Propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

I. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të pronave dhe kthimin e tyre në fond banese për qëllim strehimi dhe privatizimi .

**LISTA E PRONAVE QË DO TË NDRYSHOJNË DESTINACIONIN JANË :**

- 1.PASURIA NR .10/139-N-2 ZK 1842 ME SIPERFAQE TOTALE 36 M2 DHE SIPERFAQE NDERTIMI 36 M2  
EMERTIMI : ISH ISH ZYRAT E SHP.KURORA  
TRANSFERUAR ME VKM-në nr, 431.datë . 11.07.2007
2. PASURIA NR .10/139-N-3ZK 1842 ME SIPERFAQE TOTALE 18 M2 DHE SIPERFAQE NDERTIMI 18 M2  
EMERTIMI : ISH ISH ZYRAT SHOQATA E GJUETAREVE  
TRANSFERUAR ME VKM-në nr, 431.datë . 11.07.2007
3. PASURIA NR .9/97-N-2 ME SIPERFAQE TOTALE 130 M2  
EMERTIMI : ISH ISH DEGA E TATIMEVE KATI I PARE  
TRANSFERUAR ME VKM-në Nr.885 , datë 03.11.2010

4. PASURIA NR .9/97-N-3 ZK 1842 ME SIPERFAQE TOTALE 292 DHE NDERTESE S= 200 M2  
EMERTIMI : ISH ISH DEGA E TATIMEVE KATI PËRDHE  
TRANSFERUAR ME VKM-në Nr.885 , datë 03.11.2010

5. PASURIA NR .9/66 ZK 1842 ME SIPERFAQE TOTALE 1323 M2 DHE SIPEFAQE NDERTIMI 273 M2  
EMERTIMI : ISH GODINA E SHIKUT  
TRANSFERUAR ME VKM-në nr.1321, datë 01.10 .2008

SIPERFAQE PREJ S= 115 M2 DO TË MBETET PËR QËNDREN DITORE LULE DIELLI GRAMSH

6.PASURIA NR .7/97- ZK 1842 ME SIPERFAQE TOTALE 367 m2 NDERTESE S= 339.6 M2  
EMERTIMI : ISH NERMARJA E SHQOPAVE  
TRANSFERUAR ME VKM-në Nr.431 , datë 11 .07 .2007

7.PASURIA NR .155/3 ZK 2167 ME SIPERFAQE TOTALE 310 m2 NDERTESE S= 310 M2  
EMERTIMI : ISH OBJEKTI "Y"  
TRANSFERUAR ME VKM-në Nr.885 , datë 03.11.2010

**II.**Bashkisë Gramsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

**III .**Paraqitja e materialit pranë Drejtorise së Agjencisë Shtetërore të Kadastës Tiranë dhe për dërgimin prej saj për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave.

**IV.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise ( Sektorit Juridik dhe Menaxhimit të Aseteve Vendore) Bashkia Gramsh .

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes !

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**XHULIA GJINI**

Konceptoi: Xh.Gjini  
Pranoi: G.Lena  
Miratoi : G.Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_  
Afati i ruajtjes :

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**GRETA LENA**